



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.90/2204

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N. B., nga K., kundër të paditurës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë në Prishtinë, për shkak të detyrimit për lidhjen e kontratës së rregullt të punës dhe dëmshpërblimin e dëmtimit në pagë, përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3544/15 datë 15.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 8.03. 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET revizioni i paditësit N. B. nga K., prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3544/15 datë 15.11.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2906/12 datë 28.04.2015, ndërsa, lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3544/15 datë 15.11.2019 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e paditësit N. B. nga K. dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2906/12 datë 28.04.2015, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar të “Detyrohet e paditura

që Kontratën mbi vepër pa shkëputje që ka paditësi nga dt.1.07.2009 t'i shndërrohet në kontratë të rregullt pune; 2.T'i paguhet diferenca në koeficient në pagën bazë me kolegët e tij aktor që prej fillimit të periudhës diskriminuese 1.07.2011 në shumë prej 4201 euro (deri më dt.31.01.2015, ku pas kësaj date me vazhdimin e diskriminimit do të jetë plus 101 euro në muaj) si dhe 3 në emër të dëmit jo material të shkaktuar gjatë periudhës kohore diskriminuese (duke përfshirë shkeljet e dinjitetit, presionit psikik, humbjen e kohës dhe energjisë, shqetësimet shpirtërore, ankthin, mos përmbushjen e planeve profesionale, si dhe efektet anësore që kanë influencu në jetën familjare),t'i paguhen në kundërvlerë në shumën prej 8000 euro që në total i bie $8000 + 4201 = 12201$ euro, me kamatë vjetore sipas përqindjes së mjeteve të deponuara në bankë që nga dt.1.07.2011 e deri në marrjen dhe ekzekutimin e aktgjykimit”, dhe me pjesën e II të dispozitivit të tij, secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ka paraqitur revizion paditësi për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve të tjera të cilat gjykata zyrtarisht do ti shqyrton, me propozim që të aprovohet revizioni dhe të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, ndërsa, çështja të kthehet në rivendosje.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK-së, pretendimeve të revizionit dhe shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më dt.9.11.2012, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të detyrimit për lidhjen e kontratës së rregullt të punës dhe dëmshpërblimit të dëmtimit në pagë, me të dhënat si në petitumin e padisë dhe si në precizimin – rregullimin e sajë. Gjykata e shkallës së parë, nga administrimi i provave përkatëse, ka konsideruar se në mes të palëve nuk ishin fakte kontestuese që: Paditësi nga muaji korrik 2009 dhe në vitet pasuese(deri në v.2014) me të paditurën ka lidhur kontrata mbi vepër, me të cilat kontrata është angazhuar në detyrën aktor në TKK. Pas miratimit të Rregullores 5/2011 për pagat dhe gradimin e krijuesve, performuesve dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, për legalizimin e vendit të punës, në vazhdimësi ka parashtruar kërkesa/ankesa te e paditura. Kërkesa për legalizim të vendeve të punës, të paditurës i janë parashtruar edhe nga ana institucionit përkatësisht, nga TKK. Për shkak se e paditura nuk ka vendosur për legalizimin e vendit të punës, pas shterjes së mjeteve të brendshme juridik, paditësi i është drejtuar me ankesë KPMK dhe pasi

KPMK është shpallur jo kompetente për të vendosur në çështjen e parashtruar, brenda afatit ligjor ka kërkuar mbrojtjen gjyqësore të drejtave nga marrëdhënia e punës. Në kohën e miratimit të Rregullores 5/2011, paditësi me të paditurën për dy vite pandërprerë ka lidhur kontrata mbi vepër. Si çështje kontestuese mes palëve ishte baza ligjore e kërkesëpadsisë së paditësit, nëse me mos legalizimin e vendit të punës, paditësi në raport me kolegët tjerë aktor, është diskriminuar.

Gjykata e shkallës së parë, për vlerësimin e fakteve kontestuese, thekson se i është referuar nenit 19 Rregullores nr.5/2011 dt.23.06.2011, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila ishte nxjerrë me qëllim të përcaktimit të sistemit të gradimit dhe pagave të krijuesve dhe të performuesve të kulturës dhe të punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore që janë në varësi të MKRS-së, me të cilin, veç tjerash, përcaktohet që vendet e punës në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore legalizohen me automatizëm dhe ishin përcaktuar edhe kriteret përkatëse për legalizim, me ç’ rast, paditësi nuk e ka plotësuar kriterin- marrëdhënie e punës me kontratë mbi vepër pa shkëputje në tre vitet e fundit, nga se ai kishte vetëm dy vite pa ndërprerë, kështu nuk ka plotësuar kushtin nga neni 19 i rregullores së sipër cekur. Gjykata e shkallës së parë vlerësoi se nuk qëndrojnë as pretendimet e paditësit përkitazi me diskriminimin në punë të tij në raport me kolegët tjerë, ndaj, as me kolegun Shpejtim Kastrati dhe se nuk del se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme krahasuar me kolegët tjerë aktor të TKK.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadsia e paditësit është e pabazuar, prandaj, ka vendosur si në pjesën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.

Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndaj, ka refuzuar ankesën e paditësit, ndërsa, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të sajë.

Më pastaj, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur përkitazi me revizionin e palës paditëse, ka marrë aktgjykimin Rev.nr.451/2022 dt.23.11.2022, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3544/15 dt.15.11.2019.

Në ndërkohë, duke vepruar sipas parashtruesit të kërkesës, këtu paditësit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka marrë aktgjykimin e saj KI 137/23 dt.15 shkurt 2024, me të cilin e ka shpallë të pavlefshëm aktgjykimin Rev.nr.451/2022 dt.23.11.2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës, me konstatimin se ka pasur shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si një nga komponentët e të drejtës së përgjithshme për një gjykim të drejtë që garanton drejtësi procedurale të mishëruar në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, (E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përkatësisht, E drejta për një proces të rregullt gjyqësor), me arsyetimin se në rastin konkret nuk është respektuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit gjyqësor, e që ka të bëjë me çështjet e specifikuar, veç tjerash, si në pikat 60 deri 67 etj, të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe me rastin e rishqyrtimit të aktgjykimeve të goditura me revizion, Gjykata Supreme e Kosovës aktualisht nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e cekura janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n), dhe nenit 182.1 lidhur me nenin 2 të LPK-së, ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me shkelje nga neni 182.1 lidhur me nenin 204, përkatësisht nenit 214.1 pika b) të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e që për pasojë, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e tyre, prandaj, për këtë shkak të dy aktgjykimet u dashtë të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Sipas dispozitës së nenit 204 të LPK-së, parashihet se në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar plotësisht thëniet ankimore në kuptim të dispozitës së përmendur.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore konsistojnë në atë se ka kundërthënie midis dispozitivit dhe arsyetimit, se arsyetimi i aktgjykimit nuk përmban arsyet për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, arsyet e paraqitura janë të pa qarta dhe kontradiktore. Po kështu, nuk ka një analizë të provave të zhvilluara nga gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ato nuk janë vënë në relacion krahasues dhe vlerësues, veç e

veç e së bashku dhe se gjykata në procedurën kontestimore duhet të vendos brenda kufijve të kërkesave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, gjë që, këtu nuk është rast.

Kështu, veç tjerash, sikundër u theksua më lartë, shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se nuk janë dhënë arsyet e plota dhe ligjore lidhur me faktet vendimtare dhe nuk ka deklarim të saktë gjykatave të instancës më të ulët përkitazi me pretendimet konkrete të ngritura nga pala paditëse në të gjitha fazat e procedurës dhe të njëjtat nuk i kanë trajtuar ato pretendime, e të cilat kryesisht kanë të bëjnë me diskriminim në punë, përkatësisht, diskriminimin në pagë, që ka të bëjë me periudhën prej 1.07.2011 deri 30.04.2015, pasi që paditësi pretendon se, ka qenë i diskriminuar në raport me kolegët tjerë aktor të TKK-së përkatësisht, edhe me kolegun Sh. K., me të njëjtin kualifikim, me të njëjtin status etj, që rezulton edhe nga provat e administruara, si lista e pagave përkatëse, nga të cilat vërehet dallimi me kolegët tjerë dhe me kolegun e lartë përmendur, ndërkohë që, për këtë diskriminim flet edhe fakti se sipas listës së pagave etj, paga e paditësit, me titull aktor, në krahasim me kolegët tjerë, është ekuivalente me pagën e dy pastruesve të TKK-së, me të dhënat si në shkresat e lëndës.

Gjykatat e instancës më të ulët, nuk kishin marrë parasysh faktin se çështja e legalizimit të vendit të punës për paraqitësin e revizionit – paditësin, ishte kontestuese deri në momentin kur e paditura MKRS, më dt.12.05.2015, e kishte miratuar kërkesën për kalimin nga kontrata mbi vepër në kontratë të rregullt të punës. Ndaj, ky fakt nuk ishte më çështje kontestuese për paraqitësin e revizionit – paditësin dhe për të paditurën. Nga këtu rezulton se çështje kontestuese kishte mbetur çështja e diskriminimit në pagë dhe kompensimi i këtij dëmtimi të pretenduar, i cili sipas paditësit i referohej periudhës prej 1.07.2011 deri 30.04.2015, për çka ai, paditësi, kishte propozuar pranë gjykatës më të ulët si provë, listën e pagave, në mbështetje të pretendimit të vet, për çfarë, gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë dhënë përgjigje. Në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar se gjykatat e instancës më të ulët, nuk kanë trajtuar pretendimet dhe kërkesat e palës paditëse në mënyrë adekuate dhe nuk janë bazuar në dispozitat e nenit 5 i Ligjit të Punës, që i referohet ndalimit të gjitha llojeve të diskriminimit dhe gjithashtu nuk janë marrë për bazë as dispozitat e ligjit Kundër Diskriminimit (Ligji nr.2004/3), gjë që, në këtë rast ka qenë obligim nga se kërkesat a pretendimet e ngritura nga pala paditëse kanë të bëjnë pikërisht me këtë çështje dhe për periudhën e sipër përmendur. Është i saktë fakti se paga, lartësia e saj, drejtat dhe detyrimet tjera, punëdhënësi dhe punëtori i përcaktojnë me kontratën e punës, kjo pasi që marrëdhënia e punës konsiderohet si raport kontraktues, mirëpo, në anën tjetër, është detyrim i punëdhënësit, i cili ofron kontratën e punës për

nënshkrim për punëtorin që të paguajë punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punën e njëjtë, ose për punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar. Ndërkohë që puna e barabartë ose puna me vlerë të barabartë mbështetet në gjitha kriteret përkatëse, veçanërisht në natyrën e punës, cilësinë dhe sasinë e saj, kushtet e punës, formimin profesional dhe vjetërsinë në punë, përpjekjet fizike dhe intelektuale, përvojën dhe përgjegjësitë.

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Në rivendosje duhet që të evitohen shkeljet e paraqitura, dhe në prani të faktit se pala paditëse ka ngritur çështjen e diskriminimit në pagë në raport me kolegët tjerë – aktor në TKK, gjykata duhet të fokusohet në trajtimin e fakteve që japin përgjigje në pretendimin e paditësit lidhur me diskriminimin në pagë, sipas ndonjë baze të përcaktuar me dispozitat e ligjeve të sipër cituara, pra, se a ka pas dallim në trajtim me kolegët e tjerë dhe kategorinë e të punësuarve të cilëve u është referuar paditësi, a janë situata identike apo të ngjashme.

Nëse si në rastin konkret, paditësi pretendon se në periudhën 1.07.2011 deri 30.04.2015 është diskriminuar në pagë pasi që për pozitën e njëjtë në këtë periudhë është paguar me koeficient më të ulët se kolegët e tij që kanë punuar në të njëjtën detyrë – pozitë, atëherë gjykata është dashur të jep përgjigje lidhur me këtë se a kemi të bëjmë me punë të njëjtë, kualifikim të njëjtë, dhe në të njëjtën periudhë kolegët e paditësit çfarë koeficienti kanë pas. Kur jemi këtu, gjykata e instancës më të ulët, përkitazi me pretendimin e palës paditëse për çështjen e themelësisë ose jo të kërkesëpadisë dhe lartësisë së saj, duhet të zhvillojë dhe administroi të gjitha provat, sipas nevojës edhe ekspertizën e ekspertit përkatës financiar (aktuaristikës), të njëjtat ti analizojë në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, veç e veç, dhe të gjitha së bashku, si dhe duke pasur parasysh edhe thëniet tjera në revizion, lidhur me çështjen konkrete civile juridike, dhe në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe material, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua e në mbështetje të dispozitës së nenit 224.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.90/2024 datë 8.03.2024

Kryetar i kolegjit,
Mr.sc. Muhamet Rexha